



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:003027

Datë: 13.09.2022

Numri i dokumentit: 03415112

CP.nr.312/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, duke vendosur në lëndën e përmbartimore të kreditorit: V.H., nga fshati . . . , Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Korab Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, për shkak të pagesës së borxhit, jashtë seancës, me 13 shtator 2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore, e udhëhequr sipas shenjës CP.nr.312/2021, e iniciuar nga kreditori i përmbartimit V. H., nga fshati . . . , Komuna e Prizrenit, kundër debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditori i përmbartimit V.H., nga fshati . . . , Komuna e Prizrenit, ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit ekzekutiv Aktgjykimit C.nr.44/2020 datë 06.04.2021, i marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, i ekzekutueshëm nga data 12.05.2021, kundër debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë dhe i ka propozuar kësaj Gjykate që të lejoj përmbartimin për shkak të borxhit të debitorit ndaj këtu kreditorit.

Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, me aktvendimin CP.nr.312/2021, datë 22.06.2021, ka lejuar përmbarimin ndaj debitores Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.nr.312/2021, i datës 22.06.2021, është bërë i ekzekutueshëm Gjykata ka nxjerrë urdhër për ekzekutim, me të cilin e ka urdhëruar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitores Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të bëjë bartjen e mjeteve sikurse në urdhrin për ekzekutim CP.nr.312/2021, datë 27.08.2021, në llogari të te autorizuarit të kreditorit, avokatit Korab Bokshi.

I autorizuari i kreditorit, me parashtresën e datës 05.09.2022, ka njoftuar Gjykatën se Thesari i Kosovës, ka vepruar sipas urdhrin të Gjykatës duke i ekzekutuar mjetet për destinim për kreditorin, duke theksuar se procedura ka përfunduar në tërësi.

Meqenëse kreditori përmes të autorizuarit të tij ka njoftuar Gjykatën, se Thesari i Kosovës ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, Gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.312/2021, me 13 shtator 2022

GJ Y Q T A R I

Durim BALAJ

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të parashtrohet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.